

Lista përfundimtare e kandidatëve fitues për kuotat e trojeve për programet Bachelor dhe të integruara për vitin akademik 2016-2017

Të nderuar kandidatë,

Më poshtë mund të shihni listën përfundimtare të kandidatëve fitues për kuotat e trojeve për programet e studimit të ofruara nga Universiteti “Epoka”:

Nr.	Emër	Mbiemër	Programi i studimit	Shteti
1.	Jasin	Jahja	Ekonomiks	Maqedoni
2.	Benjamin	Jusufo	Arkitekturë	Maqedoni
3.	Leart	Beqiri	Inxhinieri Kompjuterike	Kosovë
4.	Hadis	Krasniqi	Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	Kosovë
5.	Arlind	Llolla	Administrim Biznesi	Mal i Zi
6.	Amanta	Jashari	Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik	Maqedoni
7.	Erkan	Beqiri	Financë-Bankë (shqip)	Maqedoni

Ju duhet të kryeni **regjistrimin përfundimtar** në programin përkatës të studimeve gjatë datave **13-19 shtator 2016**, duke dorëzuar në Sekretarinë Mësimore vetë ose nëpërmjet personit të autorizuar me prokurë të posaçme dokumentet e mëposhtme:

- a) *Fotokopje e dokumentit të identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë);*
- b) *Kopje të noterizuar në Republikën e Shqipërisë (dhe e përkthyer në gjuhën shqipe nëse është lëshuar në gjuhë të huaj), të diplomës së Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave, ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar në vendin përkatës, së bashku me certifikatën e notave, të legalizuar nga autoritetet drejtuese, vendore apo qendrore, të vendit ku ka përfunduar studimet,*
- c) *Vërtetimin e barasvlefshmërisë së studimeve të shkollës së mesme të lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë; Në rast se kandidati/ja ka përfunduar shkollën e mesme në Shqipëri, dorëzon kopje të noterizuar të Maturës Shtetërore së bashku me certifikatën e notave;*
- d) *Certifikatë e njohjes së gjuhës angleze (për programet që ofrohen në gjuhën angleze);*
- e) *Deklarata që autorizon trajtimin e të dhënave personale, e cila do t'i jepet kandidatit nga punonjësi i Sekretarisë Mësimore;*
- f) *Dy fotografi personale;*
- g) *Mandatpagesa e këstit të parë të tarifës së studimeve, e cila do të paguhet në llogarinë e mëposhtme:*

Banka: Banka Kombëtare Tregtare (BKT)
Mbjajtësi i llogarisë: Turgut Özal Education sh.a.
Nr. i llogarisë (Euro): 401009984
Shënim i posaçëm: Emri dhe mbiemri i studentit; Për Universitetin “Epoka”
IBAN: AL8920511014009984CLPRCFEURA

Oraret e punës së Sekretarisë Mësimore do të jenë:

13-16 shtator 2016 09:00-17:00

17-18 shtator 2016 09:00-16:00

19-20 shtator 2016 09:00-17:00

Në rast se ju jeni shpallur fitues në një program që ofrohet në gjuhën angleze dhe **nuk zotëroni certifikatë të gjuhës angleze**, ju duhet të hyni në provimin APTIS që do të organizohet në mjediset e Universitetit “Epoka”. Për të hyrë në provimin APTIS, ju duhet të kontaktoni me Zyrën e Pranimeve **brenda datës 13 shtator 2016, ora 16:00**, duke kryer pagesën e tarifës përkatëse.

Kontaktet e Zyrës së Pranimeve janë:

Admission Office/Zyra e Pranimeve

Tel: +355 4 2222 178

E-mail: admissions@epoka.edu.al